


REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
 KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Pratjeno / Pradato Received / Delivered	11. 08 2022	viti god year	2
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. / Unit	SKPM/HC	Tit. Prot. Br. Prot. Prot. No	4666/2022
Shtjeps Prilog Appendix		Sasia Kolicina Quantity	1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.576/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.576/2022 të datës 28.06.2022 të parashtruar nga ankuesi përmes përfaqësuesit të autorizuar me adresë

kundër organit të punësimit/Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike "*Masë disiplinore*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 11.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.576/2022 e datës 28.06.2022 e parashtruar nga ankuesi**
- II. Shfuqizohet Masa disiplinore "*Vërejtje*" me shenjen ZSP-Nr.67/2022 dhe me numër të protokollit 02-588 e datës 13.06.2022.**
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.**
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Drejtësisë, me datë 28.06.2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3767/2022 e regjistruar me shenjen A.nr.576/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore “Vërejtje” me shenjen ZSP-Nr.67/2022 të datës 13.06.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 01.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit te Ministria e Drejtësisë, ndërsa me datë 15.07.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me shenjen A.nr.576/2022 me numër të protokollit 3767/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 28.06.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 20.06.2022; Kopja e letërnjoftimit; Masë disiplinore ZSP-Nr.67/2022 të datës 13.06.2022; E-mail zyrtar i datës 20.06.2022; E-mail zyrtar i datës 17.06.2022; E-mail zyrtar i datës 13.06.2022; E-mail zyrtar i datës 20.06.2022; E-mail zyrtar i datës 15.06.2022; Procesverbal i datës 31.05.2022; Raporti i prezencës në punë për periudhën 01.03.2022 -31.05.2022; E-mail zyrtar i datës 20.06.2022; E-mail zyrtar i datës 01.06.2022; E-mail zyrtar i datës 31.05.2022; Njoftim i datës 24.05.2022; Vendimi Nr.47 /2022 i datës 07.04.2022; Vendimi i datës 28.03.2022; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 15.07.2022 me numër protokollit 4140/2022 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/19; Akt emërimi i datës 08.09.2014; Gjendja aktuale hyrje/dalje prej datës 01.03.2022-31.05.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 27.12.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 22.01.2021 dhe Objektivat për vitin 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e bazuar *sepse*:

Kolegji i Këshillit bazuar në provat e administruara, gjegjësisht Akt Emërimin e datës 08.09.2014 ka konstatuar se ankuesi ka statusin e nëpunësit civil dhe mban pozitën e punës *Udhëheqës i Departamentit për Profesione të Lira në Ministrinë e Drejtësisë*.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, me datë 13.06.2022, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “Vërejtje”, duke u bazuar në Raportin e veçantë të Auditimit të Brendshëm.

Kundër masës disiplinore të vërejtjes, ankuesi me datë 28.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se masa disiplinore e shqiptuar me datë 13.06.2022 është nxjerr përmes shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, shkeljes se dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë, Rregullores(QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar shkresat e lëndës, dhe rrjedhimisht ka gjetur se Zëvendësministri i Ministrisë së Drejtësisë, me datë 31.05.2022 përmes e-mailit zyrtar ka kërkuar nga I. Sh - Drejtor i Njësisë se Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë që të bëjë auditimin

e vijueshmërisë në punë për tre (3) muajt e fundit për zyrtarin _____ Udhëheqës i Departamentit për Profesione të Lira. Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, me datë 01.06.2022 ka dorëzuar raportin me shkrim të Zëvendësministri i Ministrisë së Drejtësisë, duke njoftuar të njëjtin se ankuesi gjatë periudhës tre mujore të auditimit e ka përdorë sistemin e vijueshmërisë në punë dhe se gjatë kësaj periudhe i njëjti ka qenë dy here në pushim vjetor dhe në rastet e mungesës në dy raste ka informuar zyrtaren e personelit dhe udhëheqësin e tij. Ndërsa në dy raste tjera nuk është evidentuar gjatë hyrjes në punë. Auditori i Brendshëm, të njëjtën ditë (datë 01.06.2022) ka përcjell edhe një shkresë tjetër plotësuese të Zëvendësministri i Ministrisë së Drejtësisë, duke e njoftuar të njëjtin se: *Në plotësim të shkresës së më poshtme ju informojë se tek raporti i prezencës në punë respektivisht vijueshmërisë për muajt mars, prill dhe maj zyrtari në fjalë ka edhe 9 hyrje por për të cilat në të njëjtat data nuk figuron edhe dalja, si dhe për dy raste tjera figuron dalja por mungon klikimi në hyrje. Rrjedhimisht, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka gjetur se masa disiplinore ndaj ankuesit është shqiptuar duke u bazuar pikërisht në Raportin e veçantë të Auditimit të Brendshëm lidhur me vijueshmërinë në punë të ankuesit, për periudhën 01 Mars – 31 Maj 2022.*

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, për shkelje procedurale për shkak të tejkalimit të autorizimeve ligjore nga inicuesi i auditimit të brendshëm, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave analizoi dispozitat e Ligjit Nr.06/021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.15 ku përcaktohet se: 1. Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë këto kuptime: 1.15. Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik nënkupton individin që mban pozitën më të lartë në hierarki në një subjekt publik, përgjegjës për arritjen e objektivave të organizatës, si vijon: 1.15.1 Presidenti i Republikës së Kosovës për Zyrën e Presidencës; 1.15.2. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës për Kuvendin e Republikës së Kosovës; 1.15.3. Kryeministri i Republikës së Kosovës për Zyrën e Kryeministrit; 1.15.4. Ministri përkatës për Ministrinë; 1.15.5. Drejtori i përgjithshëm, kryesuesi i institucionit apo kryeshëfi, për agjencitë e pavarura që nuk kanë bord drejtorësh; 1.15.6. Bordi i drejtorëve për agjencitë e pavarura, ndërmarrjet publike dhe fondet e veçanta (bordi këshillimor i subjektit të sektorit publik nuk është udhëheqës i subjektit); dhe 1.15.7. Kryetari i Komunës për subjektet e qeverisjes lokale, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore konstatoi se udhëheqës i subjektit të sektorit publik në sistemin ministror është Ministri, kështu që bazuar në këtë konstatim, si dhe duke ju referuar nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vlerëson se kërkesa për auditim të veçantë nuk është në autoritetin e Zëvendësministrit dhe rrjedhimisht duke marr parasysh se në shkresa të lëndës nuk është gjetur ndonjë autorizim me shkrim në kuptim të nenit 11 paragrafi 5 nën paragrafi 5.2 të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Kolegji i Këshillit konstaton se kërkesa e datës 31.05.2022 për auditim të veçantë është bere përmes tejkalimit të autorizimeve të përcaktuara me nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vlerëson se qëllimi i auditimit të brendshëm është që të ofroj siguri të pavarur dhe objektive për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe ofrimin e këshillave për përmirësimin e tij. Rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vlerëson se udhëheqësi i subjektit të sektorit publikë në kuptim të nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi

1.15.4 dhe nenit 4 të Ligjit Nr.06/021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike ka përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit të subjektit publikë, duke mos përjashtuar edhe të drejtën e parashtrimit të kërkesës për auditim të veçantë për ndonjë proces apo aktivitet të caktuar, mirëpo kërkesa për auditimin e vijueshmërinë në punë vetëm të një zyrtari publikë - nëpunësi civil, në vlerësimin e Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nuk përmban në vetvete qëllimin e përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe një kërkesë e tillë nuk është në frymën e Ligjit Nr.06/021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Për me tepër, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përkatësisht nenit 3 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilësdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, si dhe paragrafin 2 ku përcaktohet se: 2. Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvlehtësoj ose çënoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës,* Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vlerëson se kërkesa për auditim të veçantë e datës 31.05.2022 lidhur me vijueshmërinë në punë vetëm ndaj një nëpunësi civil, gjegjësisht ankuesit, ashtu sikurse edhe realizimi i auditimit të veçantë, përmban elemente të diskriminimit nga se në rastin konkret është kërkuar dhe janë ndërmarr veprime audituese lidhur me vijueshmërinë në punë vetëm për një zyrtar publikë - nëpunës civil, pa ndonjë arsyetim paraprak dhe të bazuar, duke vendosur kështu ankuesin në pozitë me pak të favorshme se nëpunësit tjerë civil në kuadër të organit të njëjtë të punësimit, veprim ky në kundërshtim me dispozitat Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Andaj, duke marr parasysh se masa disiplinore ndaj ankuesit lidhet drejtpërdrejtë me të gjeturat e Raportit të veçantë të Auditimit të Brendshëm, raport ky që u vlerësuar se përmban të meta ligjore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara dhe se akti administrativ i datës 13.06.2022 për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit është i paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për shfuqizimin e të njëjtit.

Sipas dispozitave të nenit 18 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, përgjegjës për vijueshmëri në punë të zyrtarëve publik është menaxheri drejtues, andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vlerëson se është në autoritetin e menaxherit drejtues të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale dhe ligjore për tu siguruar respektimi i orarit të punës, ndërsa në kuptim të nenit 5 të Ligjit Nr.06/021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Zyrtari Kryesor Administrativ, gjegjësisht Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit publikë, kështu që në rastet kur identifikohet mundësia e dështimit të arritjes se objektivave për shkak të mosfunksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, i njëjti mund të ndërmarr veprime për përmirësimin e sistemeve të kontrollit dhe poashtu edhe ndërmarrjen e veprimeve disiplinore me qëllim të respektimit të ligjshmërisë, mirëpo në raport me zyrtarët publikë në secilin rast duhet të respektohen parimet e menaxhimit të zyrtarëve publikë të përcaktuara me nenin 4 të Ligjit

Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nga se nëse nuk respektohen procedurat ligjore të ndërmarrjes së veprime nga organet kompetente përkundër që mund të ketë elemente të shkeljes së përgjegjësive në punë të zyrtarëve, procesin administrativë si tërësi të ndërmarrjes se veprimeve e bënë të paligjshëm dhe mbi këtë bazë përgjegjësia është e Zyrtarit Kryesor Administrativ që ka lejuar ndërmarrjen e veprimeve pa ndjekur procedurat ligjore e që rrjedhimisht mbesin pa u sanksionuar zyrtarët edhe nëse ka elemente të shkeljes së obligimeve ligjore që dalin nga marrëdhënia e punës ,pasi në rast kur kemi shkelje të dispozitave ligjore që rregullon shërbimin civil sa i përket kompetencave ligjore të ndërmarrjes së veprimeve disiplinore ndaj zyrtarëve pamundëson çështjen e vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore dhe shqyrtimit të hollësishtëm të shkeljeve që pretendohen se janë bërë nga ana e zyrtarit publik.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe të gjeturave të pasqyruar si në arsyetim të këtij vendimin si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.576/2022,datë 11/08/2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Arben Mehmeti

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Avokatit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

